

## STATUTI

### SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

#### “DM LABS” SH.P.K

Bazuar në ligjin 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar nëpërmjet Ligjit 129/2014 datë 02.10.2014, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e regjistrimit, liçensimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Tiranë, sot, më datë 05.03.2021, Unë Erli i biri i Ganiut, lindur në Bulqizë, më 03.02.1997 dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtëse e ID: J70203051L, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me vullnetin tim të lirë, në cilësinë e ortakut të vetëm themelues, pasi themelova shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “DM LABS” SH.P.K. shpall statutin e shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

#### FORMIMI

##### Neni 1

Formohet shoqëria tregtare me emërtimin “DM LABS” SH.P.K. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm pronarin themelues Erli Çupi.

##### Neni 2

Vendqëndrimi i shoqërisë tregtare “DM LABS” SH.P.K. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është në adresën: Rruga Dervish Hima, Nr.pasurise 6/369 +1+1 ,shkalla I , Kati I ,Ap.Nr.1, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të hapë edhe vend qëndrime të tjera si filiale, përfaqësi, agjensi, etj. në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ne cdo shtet tjetër të huaj, me miratim të asamblesë së përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku ato do të hapen.

Shoqëria mund të shtojë numrin e ortakëve duke ndryshuar në këtë mënyrë numrin e ortakëve dhe pjesëmarrjen e tyre në kuotat e shoqërië. Për këtë arsye për të parashikuar mënyrën e funksionimit në rastet e shtimit të ortakëve në këtë statut janë përfshirë disa klauzola të përgjithshme që garantojnë funksionimin normal në periudha tranzitore. Në rast të shtimit të numrit të ortakëve dhe shndërrimit të shoqërisë nga shoqëri me një ortak në shoqëri me shumë ortakë do të depozitohen ndryshimet në QKB dhe do të specifikohen klauzolat e statutit në përputhje me situatat e reja të krijuara.

Brenda 30 ( tridhjetë ) ditëve kalendarike nga shtimi i numrit të ortakëve asambleja e ortakëve në mbledhje të jashtëzakonshme të saj do të vendosë për ndryshime eventuale të organeve drejtuese, administratorit dhe statutit të shoqërisë.

##### Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë tregtare **“DM LABS” SH.P.K.** është e pacaktuar.

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

### **Neni 4**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare **“DM LABS” SH.P.K.** është:

Zhvillimin prodhimin administrimin dhe tregtimin e produkteve dhe shërbimeve me vlerë të lartë teknologjike si dhe aktivitete të tjera të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Veç sa më sipër në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjetër që vetëm ose së bashku me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare.

### **Neni 5**

Shoqëria tregtare mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme.

## **KAPITALI I SHOQËRISË**

### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është caktuar në shumën 100.000 lekë dhe përbehet nga 1 kuote me vlerë nominale prej 100.000 leke.  
Kapitali themeltar i takon ortakut themelues.

### **Neni 7**

Kapitali i shoqërisë tregtare mund të shtohet ose pakësohet sipas vendimeve që do të marrin organet drejtuese të shoqërisë. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur detyrimin e tij në kapitalin themelor. Pjesët e kapitalit të çdo ortaku janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, ajo përbëhet prej ortakut/ortakëve të shoqërisë. Asambleja është organi sovran i shoqërisë duke u mbështetur në të drejtën e tyre të pronësisë private mbi mjetet e investuara në shoqëri. Asambleja e Përgjithshme thirret dhe merr vendime të vlefshme sipas mënyrës së përcaktuar në dispozitat e ligjit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe miraton të drejtat dhe detyrat e organeve të saj. Të zgjedhurit dhe të emëruarit nga Asambleja veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, aktit të themelimit si dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Vendimet që merr Asambleja sipas këtij statuti dhe legjislationit në fuqi janë të detyrueshme për çdo ortak. Secili ortak ka të drejtë vote sipas përqindjes në kuotën e kapitalit themelues të shoqërisë.

thirret jo më pak se dy herë në vit. Në mbledhje të jashtëzakonshme shqyrtohen dhe vendosen probleme që kanë të bëjnë me krijimin, bashkimin, ndarjen, shpërndarjen, ndryshimin e statutit e probleme të tjera të rëndësishme për të cilat kërkohet miratimi i përbashkët nga ortaku/ortakët themelues.

#### **Neni 9**

Secili ortak që ka të drejtën e pjesmarrjes në Asamble dhe mund të përfaqesohet në të edhe nga një person tjetër i autorizuar me shkrim nga ortaku i shoqërisë.

#### **Neni 10**

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë tregtare **“DM LABS” SH.P.K.** drejtohet nga Z. Erli Çupi, i cili është njëkohësisht edhe administrator i saj.

#### **Neni 11**

Shoqëria tregtare **“DM LABS” SH.P.K.** deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të legjisllacionit shqiptar, të statutit, aktit të themelimit.

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj si person juridik në Rregjistrin Tregëtar të QKB .

Administrator i Shoqërisë është Z. Erli Çupi. Afati i emërimit në detyrë të administratorit është 5 vjet me të drejtë riuemërimi . Ky afat fillon nga 05.03.2021 deri më 05.03.2026.

Nen **“DM LABS” SH.P.K. Tiranë & Nr NUIS.** Ajo ka llogaritë e saj bankare në lekë e valutë në Bankat e Shqipërisë ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 13**

Shoqëria tregtare **“DM LABS” SH.P.K.** vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetëm të drejta dhe detyrime kontraktuale dhe jo kontraktuale brënda kapitalit të saj. Ortaku/Ortakët e shoqërisë mbartin rrezikun për rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e kapitalit themelor të shoqërisë duke mos u përgjigjur me pasuritë vetjake të realizuara në veprimtari të tjera ekonomike për detyrimet e kësaj shoqërie.

#### **Neni 14**

Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, Asambleja emëron organe kontrolli si dhe punëson persona të tjerë të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa kërkohen nga Asambleja ose largohen me dëshirën e tyre.

Administratorit me perjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator, nuk i lejohet të kontraktojë në çfarëdo forme qoftë të marrë hua në shoqëri të tjera, të japë pëlqimin në emër të shoqërisë për paradhënie e të bëhet dorëzanës apo të garantojë në emër të saj ndaj të tretëve.

#### **Neni 15**

Administratori merret me drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa kufizime. Administratori ka për detyrë të njoftojë e të japë llogari në Asamblenë e Ortakëve me përjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator dhe si i tillë i mbart vetë këto cilësi.

#### **Neni 16**

Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, Asambleja e përgjithshme nëpërmjet këtij statuti ka dhënë pëlqimin që vetëm në rastin kur shoqëria ka një ortak të vetëm i cili është edhe administrator i saj, të lejohet marrja hua prej ortakut të vetëm të saj, ndërsa për cdo rast tjetër, kjo e drejtë duhet të miratohet me një vendim përkatës të Asamblesë së përgjithshme. Kapitali i shoqërisë është lirisht i transferueshëm prej trashëgimtarëve të cdo ortaku në rast vdekjeje.

## **MARDHËNIET E PUNËS**

### **Neni 17**

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontrates së punës duke zbatuar legjislacionin shqiptar. Shoqëria merr përsipër që të respektojë rregullat në fuqi të punësimit, ndërsa të punësuarit janë të detyruar të pranojnë këtë statut dhe cdo akt që rregullon veprimtarinë e shoqërisë.

### **Neni 18**

Të punësuarit në shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe sipas statutit. Për mos zbatimet dhe dëmet që mund t'i shkaktojnë shoqërisë mbajnë përgjegjësi administrative, disiplinore e penale. Mosmarrëveshjet, që mund të lindin midis të punësuarve dhe punëdhënësit kur nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, secila palë ka të drejtë që t'i drejtohet organeve të drejtësisë.

### **Neni 19**

Punonjësit e emëruar apo të punësuar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon shoqëria në veprimtarinë e saj ekonomike, nese kontrata e punës nuk është e parashikuar ndryshe.

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës në shoqëri. Kjo është e detyrueshme dhe pas largimit nga puna e tyre.

## **PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 20**

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare "DM LABS" SH.P.K. i takon Administratorit të saj Z. Erli Çupi . Ai ka të drejtë që të përfaqësojë shoqërinë në organet gjyqësore, të lëshojë autorizime apo të bëjë prokura përfaqësimi, të caktojë e pajtojë avokat kur është e nevojshme.

### **Neni 21**

Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm të llogarive të saj, me ekspert kontabel të emëruar me ose pa afat. Ekspertët kontabel kontrollojnë e garantojnë që llogaritë vjetore të jenë të rregullta, të besueshme për rezultatin dhe gjendjen financiare. Ata kontrollojnë mbajtjen dhe evidentimin e veprimtarive financiare në përshtatje me ligjin dhe aktet e tjera për kontabilitetin. Ata janë përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat që rrjedhin nga fajet apo paaftësitë e tyre në kryerjen e detyrës.

## **BILANCI DHE TË ARDHURAT**

### **Neni 22**

Veprimtaritë ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllen në 31 Dhjetor të cdo viti. Administratori i shoqërisë nxjerr bilancin kontabel dhe raportin përketes në përputhje me dispoziten ligjore për kontabilitetin.

Raporti i administrimit, inventaret, bilancet dhe llogarite vjetore të hartuara i nënshtrohen pa përjashtim miratimit nga Asambleja e ortakeve (ortaku i vetem ) brenda afateve të caktuara.

Me miratimin e bilancit kontabël shoqëria vendos për fondet e nevojshme për zhvillimin si p.sh: fondi rezervë, atë te akumulimit, investimit etj.

### **Neni 23**

Të ardhurat neto pas vecimit të fondeve si më sipër dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale i mbesin për përdorim ortakeve të shoqërisë të cilët i ndajnë midis tyre në përputhje me kuotat e secilit në formimin e kapitalit themelor të shoqërisë përcaktuar në nenin 4 te aktit të themelimit.

Cdo ortak ka të drejtën e transferimit jashtë vendit të pjesës së fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore për këtë transferim.

Asambleja e ortakeve mund të vendosë që të shpërndahen shumat e fondeve të rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e rezerves ku janë marrë.

### **Neni 24**

Në selinë e shoqërisë tregtare mbahet dokumentacioni i plotë i saj, mbahen protokollet e ndryshme, dokumentacioni i kontabilitetit ku mund të bëhet vetkontroll ose për t'ia vënë në dispozicion cdo organi kontrolli të ngarkuar me ligj. Dokumentat e shoqërisë duhet të njihen mire nga ortaket.

## **SHPËRBËRJA E SHOQËRISË**

### **Neni 25**

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkak si në rastin e falimentimit, privimi i të drejtës për të ushtruar profesionin e tregtarit, forca madhore, raste lufte dhe cdo formë tjetër që nuk varet nga dëshira e Asamblese së ortakeve. Në cdo rast Asambleja vendos mbi mënyrën e likujdimit të shoqërisë duke caktuar një ose më shumë likujditore.

Likujditorët dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë derisa t'u dorëzohet personave përkatës fizik e juridik duke i dhënë përparësi likujdimit të detyrimit të shoqërisë ndaj të tretëve.

Mbas likujdimit të të gjithë detyrimeve ndaj të tretëve likujduesi i ndan kapitalet e mbetura mes ortakut/ortakëve përpjestimisht me kuotat që ata zoterojnë në kapitalin themelor.

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likujdimit dhe kryhen formalitetet e mbylljes Shoqëria ç'regjistrohet nga regjistri i tregtareve i QKB .

## **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

## Neni 26

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve nga Asambleja e Përgjithshme duke mbajtur parasysh kërkesat e ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Mosmarëveshjet që mund të lindin midis palëve në se nuk gjejnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Cdo ndryshim e plotësim në statut nuk prek personalitetin juridik të shoqërisë tregtare **"DM LABS" SH.P.K.**

## Neni 27

Ky statut përpilohet në katër kopje të njëjta për t'ju shpërndarë organeve përkatëse.

Një kopje i mbetet shoqërisë tregtare **"DM LABS" SH.P.K.**, si pjesë e dokumentacionit themelor të shoqërisë.

Statuti hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij dhe firmoset rregullisht nga ortaku themelues i shoqërisë.

Tiranë, më 05 Mars 2021.

**ORTAKU I VETEM**

**ERLI ÇUPI**

